

Masë nivelizuese

UZIN NC 150

Masë vetërrafshuese çimentoje për shtresëtrashësi deri në 10mm

Fushat e aplikimit:

UZIN NC 150 është masë çimentoje vetërrafshuese për rrafshimin dhe nivelizimin e nënshtresës në trashësi shtruarje nga 0 - 10 mm. I përshtatshëm për rrafshimin dhe nivelizimin e estrihëve nga çimentoja, anhidridi dhe magneziti, si dhe të pllakave të betonit, nënshtresave të vjetra dhe të jothithshme. E pasuruar me UZIN PE 520 mund të përdoret mbi estrihë nga asfalti i rrjedhshëm si dhe mbi nënshtresa të drurit apo kompensatë druri, në këtë rast duhet të armirohet me rrjetë metalike apo tekstili.

Veçanërisht është i përshtatshëm për punime në objekte banesore dhe afariste me ngarkesë normale. Për përdorim të brendshëm.

Vetitë dhe përparësitë:

UZIN NC 150 është masë çimentoje vetërrafshuese me shtesë të rrëshirës artificiale, e cila përdoret për përgatitjen e nënshtresës së rrafshët sipas standardit DIN 18365.

Përparësitë:

- ▶ Thahet shpejtë
- ▶ Shumë mirë i grryeshëm
- ▶ Rezistent ndaj ujit
- ▶ E thithshme (absorbuese)
- ▶ Forcë e njejtë në gjithë sipërfaqen
- ▶ Për trashësi nga 0 - 10 mm në një shtresë
- ▶ Për përdorim të brendshëm



	
0761	
UNIHEM d.o.o. Kajakaška c. 30; SI-1211 Ljubljana	
13	
01/05/0013.01	EN 13813:2002
masë universale rrafshuese çimentoje për aplikim të brendshëm	
EN 13813: CT-C25-F6	
Rezistenca ndaj zjarrit	A1fl
Lirues i substancave brejtëse	CT
Fortësia ndaj shtypjes	C25
Fortësia elastike	F6

Shenimet teknike:

Paketimi:	thes 25 kg
Qëndrueshmëria:	min. 6 muaj
Proporcioni i përzierjes:	cca. 7 litër ujë në 25kg
Për sasi më të vogla:	280ml ujë në 1kg pluhur
Ngjyra:	hiri
Shpenzimi:	1,5 kg për mm trashësi
Temperatura e punës:	min. +15°C mbi tokë
Koha e punës:	25 – 40 minuta*
Mund të shkilet:	pas cca. 2 orësh*
Gati për mbishtruarje:	pas cca. 24 orësh*

* Në 20°C dhe kushte normale për punë.



Përgatitja e nënshtresës:

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e fortë, pa çarje dhe substanca të cilat mund të ndikojnë negativisht në ngjitje. Të gjitha parregullsitë në nënshtresë duhet të sanohen.

Nënshtresën grryeni kështu që të gjitha pjesët jostabile apo të dobëta të sipërfaqes, mbetjet e ngjitësve apo masës rrafshuese të mënjanojnë në tërësi. Pluhurin dhe papastërtinë e imët largoni duke përdorur thithëset e përshtatshme.

Para shtruarjes së masës rrafshuese nënshtresën lyeni me një nga UZIN-astarët dhe atë për:

Estrih çimentoje ose anhidridi, beton	UZIN PE 360 D
Estrih anhidridi apo magneziti	UZIN PE 360 D
Asfalt i rrjedhshëm	UZIN PE 360 D
Dysheme të vjetra minerale apo terazzo	UZIN PE 360 D
Dysheme druri apo kompensatë druri	UZIN PE 360 D
Nënshtresa me mbetje të ngjitësve të fortë	UZIN PE 360 D
Metal	UZIN PE 460 2K
Nënshtresa me mbetje të ngjitësve ujëtrësues	UZIN PE 460 2K
Estrih çimentoje apo beton shumë i lagësht	UZIN PE 460 2K

D=disperziv

2K = dykomponentësh (patjetër të hidhet rërë kuarci)

Astarët e lartëpërmendur duhet të thahen plotësisht (testi me grithje).

Udhëzime për punë:

1. Cca. 7 litër ujë të ftohtë dhe të pastër hidhen në një enë të pastër për përzierje. Përzieni deri sa të fitoni një masë të rrjedhshme dhe pa kokrra. Për sasi më të vogël përzieni 1 kg pluhur me 280 ml ujë. Mos bëni masë shumë të hollë.
2. Masën e fituar derdheni mbi nënshtresë dhe me rrafshues metalik shpërndajeni në mënyrë njëkahëse. Koha për punimin e masës së përgatitur është 25 - 40 minuta.
3. Sipas mundësisë masën deri në trashësinë e dëshiruar shpërndajeni me një herë. Në rast të nivelizimit në disa cikle, vazhdoni punën posa shtresa e parashtuar të bëhet e shkëlqyeshme por ende e lagësht. Në të kundërtën pritni 24 orë. Shtresën e shtruar më parë lyeni me astarin (prajmerin) UZIN PE 360 dhe pas 3-4 orësh shtrojeni shtresën e re.
4. Për ngarkesë të karrigave me rrota trashësia e shtresës duhet të jetë min. 1 mm ndërsa mbi nënshtresa të jothithshme min. 2 mm.

Të dhëna të rëndësishme:

■ Koha e deponimit të mallit është së paku 6 muaj në vend të thatë dhe të ftohtë. Ambalazhën e nisur mbyllet mirë dhe me kujdes dhe sa më parë përdorenit atë.

■ Kushtet optimale për punë janë në temperaturë nga +15°C deri +25°C dhe lagështi relative të ajrit nën 75%. Temperatura e lartë dhe lagështia e ultë relative e ajrit shkurtojnë, deri sa temperatura e ultë dhe lagështia e lartë në ajër zgjasin kohën e tharjes.

■ Në ambientet me ngarkesë të shtuar, nënshtresë druri apo kompensatë druri, si dhe nënshtresa tjera problematike, rrespektoni udhëzimet për përdorimin e prodhimeve të UZIN-it.

■ Masën e përgatitur përdorenit brenda 25-40 minutash. Nxehhtësia, ajri i thatë dhe nënshtresat shumë të thithshme shkurtojnë, ndërsa ftohtësia dhe lagështia e ngritur e ajrit zgjasin kohën e lidhjes (tharjes). Dimrit punoni vetëm në ambiente të ngrohta, verës materialin depononi në vend të ftohtë. Për përgatitjen e përzierjes përdorni ujë të ftohtë dhe të pastër.

■ Në ambiente me kërkesa të larta të forcës dhe elasticitetit, apo ngrohjes tokësore, masën UZIN NC 150 pasuroni me shtojcën UZIN PE 520. Në 25 kg pluhur shtoni 6,5 litër ujë dhe 1,5 litër UZIN PE 520.

■ Veglat e punës pastroni me ujë deri sa masa të jetë e freskët.

■ Sipërfaqet e freskëta të punuara me masën nivelizuese ruani nga shkuja, dielli dhe burime të nxehhtësisë.

■ Sipërfaqet e freskëta të shtruara me masë nivelizuese janë të kalueshme (shkelshme) pas rreth 2 orësh, ndërsa të gatshme për shtruarjen e dyshemesë pas rreth 24 orësh.

■ Gjatë punës ju lutemi rrespektoni rregullat përkatëse, normat dhe udhëzimet teknike për përdorimin e prodhimeve të UZIN-it.

Mbrojtja gjatë punës dhe mbrojtja e ambientit:

Përmblan çimento! Ngacmon sytë dhe lëkurën. Ruaj larg fëmijëve. Gjatë punës përdor rroba dhe dorëza mbrojtëse. Në rast të kontaktit me sy, shpërlaj tërësisht me ujë dhe konsultoj mjekun. Kur të thahet, produkti është fizikisht dhe ekologjikisht plotësisht i padëmshëm.

Hudhja e mbeturinave:

Aty ku është e mundur, mbeturinat e prodhimit mblidheni dhe përdorni përsëri. Mbetjet e papërdorura të prodhimit mos i hudhni në kanalizim, rrjedha ujore apo deponi ilegale. Pritni deri sa të thahen, pastaj depononi në mënyrë ligjore. Ambalazhën e mbetur hudhni sipas rregullores në fuqi.